

VENDIM
Nr.3, datë 1.1.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1 germat a, c, ç, d, dh të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për t’u licencuar për aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, eksportit dhe importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., për aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, eksportit dhe importit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave, sipas “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema